



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 56

---

**Tiranë – E hënë, 11 prill 2016**

---

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 1, datë 11.2.2016	Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore 2016..... 3563
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 23.2.2016	Për procedurat e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të reja..... 3564
Udhëzimi ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 3, datë 24.3.2016	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2016..... 3577
Urdhër i ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 13, datë 1.4.2016	Për delegim kompetencash..... 3578
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 1.4.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-1091, datë 8.5.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)... 3579



## UDHËZIM

Nr. 1, datë 11.2.2016

**PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN  
E PROVIMEVE TË MATURËS  
SHTETËRORE 2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 dhe nenit 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

## UDHËZOJ:

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2016 për shkollat e mesme joprofesionale të jenë:

- a) Provime të detyruara:  
Gjuhë shqipe dhe Letërsi  
Matematikë  
Gjuhë e huaj

b) Provime me zgjedhje

1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor B1.

1.2 Lista e gjuhëve të huaja, që jepen si provim i detyruar D3, është: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Gjuha e huaj që jepet provim, pasqyrohet në formularin A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturës shtetërore 2014 dhe 2015) që rezultuan mbetës në D3, duhet të rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, që aplikojnë me A1Z, nuk do ta rijapin provimin e detyruar D3.

2. Provimet me zgjedhje

2.1 Lista e lëndëve të provimeve me zgjedhje të jetë:

Nr.	Lënda	Kredite
<b>I. Për shkollat e mesme</b>		
1	Gjuhë e huaj	10
2	Letërsi e thelluar	5
3	Matematikë e thelluar	5
4	Kimi bërthamë	4
5	Kimi e thelluar	6
6	Fizikë bërthamë	4
7	Fizikë e thelluar	6
8	Biologji bërthamë	4
9	Biologji e thelluar	6
10	Histori bërthamë	5
11	Histori e thelluar	9
12	Gjeografi bërthamë	5
13	Gjeografi e thelluar	7
14	Ekonomi bërthamë	2

15	Ekonomi e thelluar	4
16	Teknologji bërthamë	2
17	Teknologji e thelluar	4
18	Qytetari	3
19	Psikologji	2
20	Filozofi	2
21	Sociologji	2
<b>II. Vetëm për shkollat artistike</b>		
22	Histori muzike	6
23	Histori arti	6
24	Histori baleti	3

2.2 Testi i gjuhës së huaj me zgjedhje hartohet në nivelin gjuhësor B2.

2.3 Lista e gjuhëve të huaja, si lëndë me zgjedhje, përcaktohet në udhëzimin për plotësimin e formularit A1/A1Z.

2.4 Programet orientuese të lëndëve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë dhe Gjuhë e huaj), për të gjithë maturantët/kandidatët, janë në përshtatje me programet ekzistuese të shkollave të mesme.

2.5 Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.

2.6 Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin e lëndës bërthamë (përfshijë lëndët e provimeve të detyruara).

2.7 Lënda “Gjeografi” (bërthamë dhe e thelluar) përmban edhe lëndën “Shkenca e tokës”.

2.8 Maturanti/kandidati zgjedh dy lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse i ka zhvilluar ose jo, apo i janë ofruar ose jo ato nga shkolla në programin mësimor.

3. Maturanti/kandidati zgjedh lëndët për provimet me zgjedhje sipas këtyre kriterëve:

a) Shuma e krediteve të këtyre lëndëve të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).

b) Numri i lëndëve të jetë 2 (dy).

c) Nga “Lista e lëndëve me zgjedhje”, maturanti i shkollave artistike, koreografike ka të drejtë të zgjedhë:

- Lëndën e parë, nga grupi i lëndëve “II. Vetëm për shkollat artistike”.

- Lëndën e dytë, nga grupi i lëndëve “I. Për të gjitha shkollat e mesme”.

d) Maturanti/kandidati, kur zgjedh një lëndë të thelluar, nuk mund të zgjedhë njëkohësisht të njëjtën lëndë bërthamë (përfshijë lëndët: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë dhe Gjuhë e huaj).

4. Kandidati, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë



të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50, (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i rijapë më.

5. Kandidatët, të cilët:

a) Rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore, duhet t'i rijapin ato që të pajisen me diplomë.

b) Nuk kanë dhënë provimet me zgjedhje ose nuk kanë rezultuar kalues, por janë të pajisur me dëftesë pjekurie, do t'i japin ato në përputhje me këtë udhëzim.

6. Kandidatët, që në Maturën Shtetërore 2012 kanë zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe:

a) Kanë mbetur në dy provime, të zgjedhin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi.

b) Rezultojnë kalues në dy prej tyre, të pajisen me diplomën e maturës.

7. Kandidatëve, të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2006 dhe dëshirojnë të aplikojnë për studime universitare, t'u njihen dy nga provimet e detyruara që përputhen me D1 dhe D2, ose provimet e njëvlershme me to, të njehsuara nga DAR/ZA-të. Përveç kësaj, ata duhet të japin provimet me zgjedhje mbështetur në këtë udhëzim.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Maturës Shtetërore, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Institutit i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
Lindita Nikolla

### UDHËZIM

Nr. 2, datë 23.2.2016

#### **PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT, MIRATIMIT, POROSITJES, SHPËRNDARJES DHE SHITJES SË TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA**

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen

dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar,

#### UDHËZOJ:

I. Të përgjithshme:

##### **a) Tekste shkollore të reja:**

Kërkesat për tekste shkollore të reja dhe afatet kohore të procedurave të konkurrimit, miratimit, shpërndarjes dhe shitjes së tyre, të përcaktohen me urdhër të veçantë të ministrit.

##### **b) Tekstet dixhitale:**

Procedurat e konkurrimit, miratimit, porosities, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore dixhitale, do të përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit.

##### **c) Hartimi i teksteve shkollore të reja:**

Hartimi i teksteve shkollore të reja të bëhet në përputhje me programet mësimore përkatëse dhe në respektim të standardeve të teksteve shkollore, të miratuara nga MAS-i.

##### **ç) Pjesëmarrësit në konkurrim:**

1. Botuesit vendas ose të huaj dhe/ose distributorët e teksteve të gjuhëve të huaja, të botuesve të huaj, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrimin për tekstet shkollore të reja, nëse e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shpenzimet e konkurrimit përballohen nga konkurruesi.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim

##### **a) Dokumentacioni ligjor i subjekteve pjesëmarrëse në konkurs:**

1. Për pjesëmarrjen në konkurs, subjektet të dorëzojnë, në afatet e caktuara në urdhrin e ministrit, dokumentet e mëposhtme, në origjinal ose të noterizuara:

1.1 Ekstraktin historik nga QKR-ja për regjistrimin si person juridik, me të drejtë ushtrimi aktiviteti si botues dhe/ose distributor;

1.2 Certifikatën e regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë tregtare;

1.3 Vërtetimin nga gjykata dhe vërtetimin nga prokuroria që botuesi dhe/ose distributori nuk është në ndjekje penale.

1.4 Vërtetimin nga Drejtoria e Tatimeve dhe e Taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

2. Dokumentacioni i mësipërm të paraqitet te marrësi në dorëzim, i përcaktuar nga MAS-i dhe të shqyrtohet në prani të dorëzuesit. Mungesa, qoftë



dhe e njërit prej dokumenteve të përcaktuara më sipër, sjell mospranimin në konkurs të subjektit.

**b) Dokumentacioni teknik për tekstet shkollore të reja për konkurrim:**

Subjekti/subjektet për çdo titull teksti shkollor që dorëzon për konkurrim, në zarf të bardhë, format A4, të mbyllur dhe të dyllosur, pa shenja të jashtme dalluese që mund të zbulojnë përkatësinë e zarfit, të paraqesë këto dokumente, në original ose të noterizuara:

1. Deklaratën e botuesit për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Bëjnë përjashtim botuesit dhe autorët e huaj të titujve përkthime dhe të gjuhëve të huaja.

2. Deklaratën për të drejtën e botimit, mbi origjinalitetin e veprës në tërësi dhe të pjesëve të veçanta të saj, si dhe kopje të akteve ose të marrëveshjeve që mund të jenë bërë për aplikimin, për marrjen e lejes ose blerjen e elementeve të veçanta të së drejtës së autorit nga të tretët, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Deklaratën për autorësinë e tekstit, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kontratën/at e lidhur/a ndërmjet botuesit dhe autorit/ëve. Për tekstet përkthime para-kontratën e përkthyer të lidhur me botuesin e huaj; për tekstet e huaja të gjuhëve të huaja, dokumentin e përkthyer të botuesit të huaj për dhënien e së drejtës së përfaqësimit në konkursin e teksteve shkollore dhe të shpërndarjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Deklaratën për çmimin e shitjes me pakicë të tekstit shkollor, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Të dhëna për autorin/ët e tekstit shkollor, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi bëjnë përjashtim autori/ët e teksteve përkthime nga botues të huaj dhe ata të teksteve të gjuhëve të huaja të botuesve të huaj.

7. Të dhëna për ekipin realizues të tekstit shkollor, sipas shtojcës 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Bëjnë përjashtim ekipet realizuese të teksteve përkthime nga botues të huaj dhe të teksteve të gjuhëve të huaja të botuesve të huaj.

**c) Pranimi i teksteve shkollore të reja për konkurrim:**

1. Subjekti të dorëzojë për konkurrim 5 (pesë) kopje të çdo titulli teksti shkollor të ri.

2. Çdo kopje të jetë e radhitur, e faqosur dhe e

shtypur me letrën dhe në formatin siç parashikohet të dalë nga shtypi.

3. Çdo kopje të jetë e lidhur me vrima e me kapëse plastike, me ngjyrë të zezë; të mos ketë kopertina e frontespice; faqet të mos përmbajnë elemente që mundet të identifikojnë përkatësinë e tekstit shkollor.

4. Asnjë prej kopjeve të teksteve të paraqitura për konkurrim të mos përmbajë shenjat e zakonshme të identifikimit që i ka teksti kur është i gatshëm për përdorim, si: autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese etj.

5. Në çdo kopje që do të dorëzohet, titulli i tekstit të shkruhet sipas emërimit të bërë në urdhrin përkatës të MAS-it. Ai të shkruhet me ngjyrë të zezë, në llojin e letres së bllokut të librit, me germa të mëdha shtypi, tip “Bookman Old Style”, *bold*, me madhësi 36-she. Në rast moszbatimi të kësaj kërkesë, teksti shkollor të mos pranohet për konkurrim.

6. Numrat rendorë të faqeve të jenë të shkruara në anën e djathtë, poshtë, të çdo faqeje, në tipin e germave të vogla “Bookman Old Style”, me madhësi 12-she, me ngjyrë të zezë, jo *bold*.

7. Kopjet e teksteve të huaja, të gjuhëve të huaja, të paraqiten pa kopertinën dhe frontespice; si kopertinë, në formatin e bllokut, t’u ngjitet letër e bardhë 80g/m<sup>2</sup>, ku titulli të shkruhet sipas përcaktimit të bërë në pikën 5 më lart.

Në rast pranimi të dokumentacionit ligjor, dokumentacionit të tekstit/eve dhe të teksteve për konkurrim, marrësi i jep subjektit një nga dy kopjet e formularit për marrjen në dorëzim.

Dokumentacioni ligjor, dokumentacioni i tekstit/eve dhe tekstet e pranuar për konkurrim, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, të mos i kthehen subjektit dorëzues.

III. Vlerësimi i teksteve shkollore

**a) Ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Teksteve Shkollore (KVTSH):**

1. Për menaxhimin e procesit të konkursit për tekstet e reja shkollore, të ngrihet dhe të funksionojë KVTSH-ja dhe Sekretaria Teknike.

2. Përbërja e KVTSH-së dhe e Sekretarisë Teknike, caktohet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

3. Parimet e funksionimit të KVTSH-së janë ligjshmëria, paañësia, objektiviteti, konfidencialiteti, dhe transparenca.

4. Anëtarë i KVTSH-së dhe i Sekretarisë



Teknike, nuk mund të jetë autor në tekstet shkollore, botues apo pronar shtypshkronje.

5. Vendimet e KVTSH-së, bazohen në procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluara, të zbardhen dhe konsiderohen akte administrative.

#### **b) Kompetencat e Komisionit të Vlerësimit të Teksteve Shkollore**

1. Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore, të ketë për kompetencë:

a) Verifikimin e përputhjes së dokumenteve të botuesit dhe/ose distributorit me kërkesa dhe kushtet e vëna për konkursin për tekste shkollore të reja.

b) Përzgjedhjen dhe caktimin e recensuesve (vlerësuesve) të teksteve shkollore të reja, sipas kritereve të vendosura për vlerësimin e teksteve.

c) Sigurimin e recensimit (vlerësimit) të teksteve shkollore të reja konkurruese, duke ruajtur anonimat.

ç) Analizimin dhe përpunimin e vlerësimit të recensuesve për tekstet shkollore të reja për lëndë/klasë.

d) Renditjen e teksteve shkollore të reja për lëndë/klasë/profil sipas pikëve, pas përfundimit të vlerësimit.

dh) Shpalljen e vendimit për renditjen përfundimtare të teksteve shkollore të reja për lëndë/klasë/profil sipas pikëve, pas përfundimit të afatit të ankimeve.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, për aspekte/elemente që i takojnë fushës së tij të veprimtarisë, KVTSH-ja të bashkëpunojë me strukturat e MAS-it.

#### **c) Funksionet e Sekretarisë Teknike, të Komisionit të Vlerësimit të Teksteve Shkollore**

Sekretaria Teknike e KVTSH-së, të ketë këto funksione:

a) merr në dorëzim dokumentacionin e paraqitur nga konkurrentët;

b) kodon dokumentacionin e paraqitur nga konkurrentët;

c) i dorëzon KVTSH-së listën e aplikimeve me të dhënat e aplikuesve në konkurs;

ç) u dorëzon recensuesve (vlerësuesve) dhe merr prej tyre tekstet e koduara që vlerësohen;

d) mban protokollin dhe procesverbalet e mbledhjeve të KVTSH-së;

dh) zbardh vendimet e KVTSH-së;

e) kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga KVTSH-ja;

#### **ç) Funksionimi i brendshëm i KVTSH-së**

1. KVTSH-ja të ngrihet dhe të funksionojë sipas statusit ligjor të organeve kolegjiale.

2. Kryetari i KVTSH-së të organizojë dhe të drejtojë mbledhjet e KVTSH-së, të ndajë detyrat për anëtarët, të përfaqësojë KVTSH-në në marrëdhënie me palët e treta dhe të nënshkruajë vendimet e KVTSH-së.

3. Vendimet e KVTSH-së të merren me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve.

4. Procesverbalet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

5. KVTSH-ja të hartojë katalogun e teksteve shkollore të reja që do të përdoren nga nxënësit.

6. Katalogu të shpallet nga KVTSH-ja pas miratimit të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

7. KVTSH-ja, të hartojë dhe të miratojë rregulloren e saj të brendshme.

#### **ç) Renditja e teksteve shkollore të reja për lëndë/klasë dhe shpallja e listës paraprake të teksteve shkollore të reja fituese**

1. KVTSH-ja, mbi bazën e vlerësimeve të recensuesve, të nxjerrë vlerën mesatare të standardeve për secilin tekst shkollor të ri, për lëndë/klasë.

2. KVTSH-ja shpall listën e teksteve shkollore fituese. Lista të përmbajë deri në tri alternativa për çdo lëndë/klasë. Tri alternativat të jenë nga një për secilën nga shtëpitë botuese “Oxford University Press”, “Pearson” dhe “Cambridge”.

3. Shpallja të bëhet në prani të të gjitha subjekteve të interesuara, njëkohësisht me procedurën e hapjes së zarfit të dyllësuar me dokumentet e secilit prej titujve të paraqitur për konkurrim.

#### **d) Shpallja përfundimtare e listës së teksteve shkollore të reja**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas përfundimit të afateve për ankimin, të shpallë listën përfundimtare të teksteve shkollore të reja.

#### **IV. Çmimi i teksteve shkollore të reja**

1. Çmimet e propozuara të shitjes me pakicë të teksteve shkollore të reja të dorëzohen nga botuesit/distributorët në MAS, në zarf të mbyllur. Pas hapjes, ato t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga KVTSH-ja.

2. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të përmbajtjes së teksteve shkollore të reja, KVTSH-ja, në prani të botuesve/distributorëve, të bëjë hapjen e zarfeve ku ndodhen edhe formularët



përkatës të çmimeve të shitjes me pakicë, propozuar për çdo tekst/lëndë, nga çdo botues/distributor. Një kopje e procesverbalit të hapjes të vihet në dispozicion të palëve pjesëmarrëse në proces.

3. Pas renditjes së teksteve sipas përmbajtjes, për tekstet që rezultojnë fituese, KVTSH-ja të bëjë përllogaritjen dhe vlerësimin e çmimit mesatar aritmetik ose çmimit tavan të teksteve fituese.

4. Çmimi mesatar aritmetik ose çmimi tavan të përllogaritet si shumatore e çmimeve të propozuara nga botuesit/distributorët për çdo titull teksti fitues, pjesëtuar me numrin e alternativave fituese për këtë titull. Çmimi tavan të aplikohet për ato tekste për të cilat çmimi i propozuar nga subjekti e tejkalon çmimin tavan, ndërsa për tekstet e ofruara me çmim poshtë çmimit tavan, si çmim i shitjes me pakicë të vendoset ai i propozuar nga botuesi/distributori.

5. Shembull i përllogaritjes së çmimit të teksteve shkollore të reja:

Titulli “Dituri natyre 2”

Botuesi “X”, me çmim të propozuar 500 lekë;

Botuesi “Y”, me çmim të propozuar 550 lekë;

Botuesi “Z”, me çmim të propozuar 450 lekë.

Çmimi tavan për titullin e mësipërm rezulton të jetë 500 lekë (shuma (500 + 550 + 450)) e pjesëtuar me 3). Për botuesin “Y” çmimi i shitjes me pakicë vlerësohet dhe miratohet 500 lekë, për botuesin “Z” ai është 450 lekë, kurse për botuesin “X” mbetet 500 lekë.

6. Nëse çmimi tavan i përllogaritur nga KVTSH-ja, sipas pikave 4 dhe 5, të pikës IV ose çmimet e propozuara poshtë çmimit tavan nga subjektet, për tekstet e vlerësuara, tejkalojnë marzhin 10% mbi çmimin më të lartë të tekstit analog (të njëjtit tekst të aplikuar në vitin e mëparshëm), KVTSH-ja t’u kërkojë subjekteve të kualifikuara analizë të detajuar të çmimit dhe të vlerësojë çmimin e propozuar nga subjekti. Çmimi përfundimtar i teksteve të miratuara të mos tejkalojë marzhin maksimal prej 10% mbi çmimin e tekstit analog të aplikuar në vitin e mëparshëm.

7. Për tekstet të cilat hyjnë në qarkullim për herë të parë dhe nuk ka tekste analoge që mund të përdoren si referencë nga vitet e mëparshme, vlerësimi i çmimit të bëhet nga KVTSH-ja, bazuar në çmimin mesatar aritmetik/çmimin tavan, sipas mënyrës së përllogaritjes të përcaktuar në pikat 4 dhe 5 të këtij kreu. Çmimi përfundimtar i teksteve

të miratuara të mos tejkalojë marzhin maksimal prej 5 % mbi çmimin më të lartë të tekstit të vitit shkollor 2016–2017.

8. Nëse në përfundim të procesit të vlerësimit rezulton një tekst i kualifikuar, çmimi i tekstit të jetë ai i propozuar nga subjekti dhe KVTSH-ja të përllogarisë çmimin, duke mbajtur në konsideratë se çmimi i propozuar nga subjekti të mos kalojë çmimin tavan në tekstin analog të një viti të mëparshëm të indeksuar me normën zyrtare të inflacionit sipas INSTAT-it.

V. Ankimi i vendimeve të KVTSH-së

#### a) E drejta për ankim

Çdo palë që ka një interes të ligjshëm lidhur me procesin e konkurrimit dhe përzgjedhjes së teksteve shkollore të reja, ka të drejtën e ankimit të vendimeve të KVTSH-së.

#### b) Afati për paraqitjen e ankimeve

Botuesit/distributorët kanë të drejtën e ankimit brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e dijeni, por jo më shumë se 10 ditë pune nga marrja e vendimit.

#### c) Forma e ankimeve

Ankesa paraqitet nga drejtuesi ligjor i subjektit. Ankesat depozitohen me shkrim në zyrën e protokollit të MAS-it. Në ankesë të përshkruhet dhe interesi i ligjshëm lidhur me procesin e konkurrimit.

#### ç) Shqyrtimi i ankesave

Ankesat shqyrtohen brenda 5 ditëve pune nga KVTSH-ja. KVTSH-ja të shprehët me vendim të argumentuar mbi ankesën, duke e pranuar ose rrëzuar atë.

Lidhur me vendimmarrjen e KVTSH-së, për ankesat e paraqitura, subjekti ka të drejtën e ankimit te ministri, brenda 3 ditëve pune nga marrja e dijeni, por jo më shumë se 10 ditë pune nga marrja e vendimit, pranë ministrit të Arsimit dhe Sportit. Ministri i Arsimit dhe Sportit shqyrton ankesën brenda 10 ditëve.

Vendimmarrja e ministrit lidhur me ankimin është përfundimtare.

#### VI. Konflikti i interesit

1. Në procesin e hartimit të teksteve shkollore të reja, punonjësit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, punonjësit e institucioneve të varësisë, recensuesit (vlerësuesit) dhe anëtarët e KVTSH-së, nuk mund të jenë autorë teksti shkollor, botues, distributorë të teksteve të huaja të gjuhëve të huaja, pronarë shtypshkronje, si dhe duhet të deklarojnë gjendjen e konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të ligjit



nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

2. Çdo anëtar i KVTSH-së dhe çdo recensues/vlerësues, para fillimit të punës të plotësojë dhe të nënshkruajë deklarin për pajtueshmërinë me ligjin për konfliktin e interesit, respektivisht sipas formularëve 7 dhe 8, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

VII. Detyrimet e shtëpive botuese/distributorëve

1. Botuesi/distributori të marrë përsipër dhe të mbajë përgjegjësi për marrëdhëniet e tij me autorët e teksteve, për përgatitjen për shtyp të origjinaleve të teksteve, për zbatimin e kërkesë/porosive për tekste nga shkollat, për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore në njësitë tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave, nga subjekte të licencuara.

2. Botuesi/distributori, në kopertinën e çdo kopjeje të tekstit, të shënojë të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Botuesit fitues të titujve përkthime të paraqesin kontratën përfundimtare me botuesin e huaj, të përkthyer dhe të notuar.

VIII. Porositja e teksteve shkollore të reja

1. Për vitin shkollor përkatës të shpallet katalogu i teksteve shkollore të reja.

2. Porositja e teksteve, të bëhet mbi bazën e përzgjedhjes së realizuar sipas udhëzimit përkatës të ministrit të MAS-it

3. Drejtori i shkollës, të dërgojë zyrtarisht porosinë për tekste te botuesit/distributor. Drejtoritë përcjellë në DAR/ZA tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve shkollore të përzgjedhura, brenda afateve të përcaktuara.

4. DAR/ZA, brenda afateve të përcaktuara të dërgojë në MAS tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve të përzgjedhura dhe të porositura nga shkollat.

5. Drejtorët e shkollave të pakicave kombëtare, t'i dërgojnë shtëpisë botuese BOTEM, brenda afateve të përcaktuara, porosinë e tyre për tekste shkollore të reja.

IX. Shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore të reja

1. Për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të reja janë përgjegjës botuesit/distributorët.

2. Shitja e teksteve shkollore të bëhet në njësitë tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave, nga subjekte të licencuara.

3. Shkolla mund të vërë falas në dispozicion të personave të ngarkuar nga shpërndarësit e teksteve (librashitësit), një ose dy klasa të sigurta për shitjen e teksteve shkollore me hologramën e MAS-it.

4. Përgjegjësi i sektorit të kurrikulës në DAR/përgjegjësi i sektorit të kualifikimit dhe cilësisë në ZA është personi përgjegjës (pikë kontakti), që mban lidhje të vazhdueshme me MAS-in dhe informon për mbarëvajtjen e proceseve të shpërndarjes dhe shitjeve të teksteve.

5. Subjekteve të licencuara për shitjen e teksteve shkollore të mos u lejohej të shesin në shkollë libra që nuk i përkasin katalogut të teksteve shkollore të vitit shkollor përkatës.

6. DAR/ZA-të, gjatë dy javëve para fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas tij, të raportojnë në MAS çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme, për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.

7. ISHA-ja, pas monitorimit të procesit të shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore, t'i raportojë me shkrim ministrit të Arsimit dhe Sportit.

X. Dispozita të fundit

1. Dokumentacioni ligjor lidhur me procesin e konkurrimit, miratimit, porositjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të reja (aktet, programet mësimore, standardet e teksteve shkollore etj.), si dhe çdo material tjetër shpjegues për të interesuarit, të publikohen në faqen zyrtare të MAS-it: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al).

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore në MAS, DAR/ZA, ISHA dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**



SHTOJCA 1  
DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E  
KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Deklaroj se asnjë prej autorëve, recensuesve, redaktorëve shkencorë/letrarë dhe përkthyesit/përshtatësit, të përfshirë në shtojcat 3 dhe 6 të bashkëlidhura udhëzimit, të tekstit shkollor me titull:

\_\_\_\_\_, dorëzuar për konkurrim në MAS, nuk është i lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të MAS-it dhe institucioneve të saj të varësisë.

Deklaroj, po ashtu se, nënshkruesi i kësaj deklarate nuk është i lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të institucioneve të përmendura më lart.

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201 \_\_\_\_

**PËR BOTUESIN/DISTRIBUTORIN**

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

\_\_\_\_\_





SHTOJCA 2  
DEKLARATA PËR TË DREJTËN E BOTIMIT

Deklaroj se “E drejta e botimit” e tekstit me titull:

\_\_\_\_\_ ,  
dorëzuar për konkurs në MAS:

Pjesa e tekstit ose teksti në tërësi	Zotëruesi	Burimi
1. _____	_____	_____
2. _____	_____	_____
3. _____	_____	_____
4. _____	_____	_____
5. _____	_____	_____
6. _____	_____	_____

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201\_\_\_\_

**PËR BOTUESIN/DISTRIBUTORIN**

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

**Shënim për plotësimin e formularit:**

Si pjesë të tekstit, për efekt të burimit të së drejtës së botimit, mund të përfshihen edhe ilustrime, ide, punë editoriale. Zotërimi i kësaj të drejte nga subjekti përkatës duhet të dëshmohet në kontratën përkatëse midis autorëve dhe botuesit ose me dokumente të blerjes apo dhurimit të kësaj të drejte nga të tretë, kopje të noterizuara të të cilave i bashkëlidhen kësaj deklaratë. Në rastet kur e drejta e botimit është fryt i punës origjinale të vetë subjektit, në kolonën e tretë për burimin e së drejtës së botimit shënohet “Punë origjinale”. Në kolonën e burimit të së drejtës së botimit shënohet, sipas rastit: “Origjinale” ose “Nga të tretë” (shënohet në kllapa pala e tretë dhe përfshihet dokumenti i blerjes apo dhurimit).



SHTOJCA 3  
DEKLARATË PËR AUTORËSINË E TEKSTIT

Deklaroj se autorët e tekstit me titull: \_\_\_\_\_,  
dorëzuar për konkurs në MAS, janë:

Emri, mbiemri	Pjesa e tekstit (kapitujt ose thjesht bashkautorësi)
1.	
2.	
3.	
4.	

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201 \_\_\_\_

**PËR BOTUESIN/DISTRIBUTORIN**

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

\_\_\_\_\_



SHTOJCA 4  
DEKLARATË PËR ÇMIMIN E SHITJES ME PAKICË TË TEKSTIT

Deklaroj se çmimi i shitjes me pakicë të tekstit me titull \_\_\_\_\_,  
dorëzuar për konkurs në MAS, është \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_)  
(me shifra) (me shkrim)  
lekë.

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201\_\_\_\_

**PËR BOTUESIN/DISTRIBUTORIN**

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)



SHTOJCA 5  
TË DHËNA PËR AUTORIN/ËT E TEKSTIT

Grupi i autorëve	Po	Jo
Autor i vetëm, pedagog	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Autor i vetëm, mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dy ose më shumë pedagogë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Dy ose më shumë mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pedagog dhe mësues	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Më shumë se dy mësues dhe pedagogë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Formimi universitar: (titulli i diplomës që zotëron)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Diplomuar brenda vendit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Diplomuar jashtë vendit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Formimi pasuniversitar dhe titulli shkencor/ akademik:**

Titulli	Brenda vendit	Jashtë vendit
Master	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Doktor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Profesor i Asociuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Profesor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Akademik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**Përvoja pedagogjike:**

-Mësues i lëndës \_\_\_\_\_ vjet

-Pedagog i lëndës \_\_\_\_\_ vjet

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 201\_\_\_\_\_

**PËR BOTUESIN/DISTRIBUTORIN**

(emri zyrtar i subjektit)

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

**Shënim për plotësimin e formularit:** Të dhënat përkatëse të pasqyrohen brenda kutisë duke përdorur simbolin “X”.



SHTOJCA 6  
TË DHËNA PËR REDAKTORËT SHKENCORË/LETRARË DHE  
PËRKTHYESIT/PËRSHTATËSIT

**1. Redaktorët shkencorë:**

a) Redaktori i parë \_\_\_\_\_

Shkolla e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka) \_\_\_\_\_

Shkolla e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

**2. Redaktorët letrarë:**

a) Redaktori i parë \_\_\_\_\_

Shkolla e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b) Redaktori i dytë (në qoftë se ka) \_\_\_\_\_

Shkolla e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

**3. Përkthyesi/përshtatësi**

a) I parë \_\_\_\_\_

Shkolla e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

b) I dytë (në qoftë se ka) \_\_\_\_\_

Shkolla e kryer:	I punësuar në
	Punëdhënësi:

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201\_\_\_\_

**PËR BOTUESIN/DISTRIBUTORIN**

(emri zyrtar i subjektit)

\_\_\_\_\_

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

\_\_\_\_\_



SHTOJCA 7  
DEKLARATË E ANËTARIT TË KVTSH-SË PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR  
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

**DEKLARATË**

I nënshkruari \_\_\_\_\_, anëtar i KVTSH-së në MAS, deklaroj se nuk kam dorëzuar për konkurrim në MAS tekst shkollor të ri, nuk jam i lidhur me interesa familjare ose financiare me punonjës të MAS-it dhe institucioneve të tij të varësisë.

Deklaroj, po ashtu, se me asnjë nga botuesit/distributorët dhe me punonjës të këtyre institucioneve nuk kam lidhje për interesa familjare ose financiare.

**DEKLARUESI**

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_ 201\_\_\_\_\_



SHTOJCA 8  
DEKLARATË E RECENSUESIT/VLERËSUESIT PËR PAJTIMIN ME LIGJIN PËR  
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

**DEKLARATË**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me të dhënat e mëposhtme deklaroj nën përgjegjësinë dhe vullnetin tim të plotë se nuk kam konflikt interesi të asnjë lloji për të marrë pjesë në vlerësimin e teksteve shkollore të reja, sipas standardeve për tekstet shkollore dhe në përputhje me aktet ligjore për tekstet shkollore.

Në mënyrë të veçantë pohoj, se:

- Nuk jam autor i asnjë prej teksteve shkollore të reja.
- Nuk jam recensues apo anëtar i ekipit realizues: redaktor shkencor, redaktor letrar, faqosës etj., i asnjë prej teksteve shkollore të dorëzuara për konkurrim në MAS. (KVTSH)
- Nuk kam lidhje farefisnie me pronarë të shtëpive botuese që marrin pjesë në procesin e prodhimit të teksteve shkollore të dorëzuara për konkurrim në MAS (KVTSH) etj.

**DEKLARUESI**

(emri, mbiemri, nënshkrimi) \_\_\_\_\_

Mësues (pedagog) në shkollën (universitetin)

\_\_\_\_\_

Arsimi i kryer (universiteti, instituti, akademia, kolegji...), profili

\_\_\_\_\_

Telefon + celular: \_\_\_\_\_

E mail: \_\_\_\_\_

Adresa postare:

Rruga: \_\_\_\_\_ Lagjja: \_\_\_\_\_ Bashkia/rrethi: \_\_\_\_\_

Emri i bankës: \_\_\_\_\_

IBAN: \_\_\_\_\_ Nr. i llogarisë: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 201 \_\_\_\_



## UDHËZIM

Nr. 3, datë 24.3.2016

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE  
KOMBËTARE TË MATURËS  
SHTETËRORE 2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

## UDHËZOJ:

## Neni 1

Lëndët dhe datat e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore

1. Lëndët dhe datat e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore janë:

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| a) Gjuhë e huaj             | 4 qershor 2016;  |
| b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi | 11 qershor 2016; |
| c) Matematikë               | 17 qershor 2016; |
| d) Provime me zgjedhje      | 24 qershor 2016. |

## Neni 2

**Administrimi i provimeve**

1. Administrimi i provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 91, datë 2.3.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

2. Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve, brenda muajit mars 2016, përcaktojnë llojin e testeve për secilin provim kombëtar të Maturës Shtetërore (të detyruar dhe me zgjedhje).

## Neni 3

**Masa për mbarëvajtjen e provimeve**

1. DAR/ZA-tëtë marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit mësimor 2015–2016, brenda datës 3 qershor 2016, dhe t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik “Matura *online*”, sipas udhëzimit përkatës. DAR/ZA-të dërgojnë në AKP, të printuar dhe në kopje elektronike, listat e maturantëve mbetës të vitit për çdo shkollë.

2. Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

3. Organizimi i konsultimeve për maturantët

kryhet sipas procedurave të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, “Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë”.

4. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 zhvillohen dhe organizohen sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

5. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 zhvillohen në mjediset e institucioneve arsimore, sipas parashikimeve përkatëse të Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

6. Teza e provimit “Gjuhë dhe letërsi greke” për shkollën e mesme pedagogjike të pakicës kombëtare greke përgatitet nga DAR-ja Gjirokastrë.

7. Teza e provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet në datën 23 maj 2016 në shkollat përkatëse.

8. Teza e provimit “Gjuhë frënge” (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 23 maj 2016 në shkollat përkatëse.

Tërheqja e testeve të provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 bëhet sipas grafikut të hartuar nga AKP-ja dhe të miratuar nga MAS-i. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në AKP materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit janë të paketuara për çdo mjedis më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet sipas parashikimeve përkatëse në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 4

**Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore**

1. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje fillojnë në orën 10:00.

2. Hartimi i testeve të provimeve të detyruara dhe atyre me zgjedhje bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

3. Testi për secilin nga provimet e detyruara





përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje përmban 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.

5. Provimet e detyruara zgjasin 2 orë e 30 minuta.

6. Testi i provimit të detyruar të gjuhës së huaj hartohet, administrohet dhe vlerësohet nga AKP-ja.

7. Testi i provimit me zgjedhje të gjuhës së huaj Anglisht “TOEFL Junior Standard Test” hartohet dhe vlerësohet nga ETS Global, në bazë të marrëveshjes ndërmjet Education Testing Service Global BV dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

8. Provimet me zgjedhje zgjasin 3 orë. Provimi i gjuhës së huaj Anglisht “TOEFL Junior Standard Test” zgjat 1 orë e 55 minuta.

9. Maturantët/kandidatët që japin provim vetëm njëherë nga lëndët me zgjedhje, fillojnë provimin në orën 11:30 dhe e përfundojnë atë në orën 13:00.

10. Maturantët/kandidatët që japin dy provime me zgjedhje, ku njëra prej tyre është gjuhë e huaj Anglisht “TOEFL Junior Standard Test”, hyjnë në provimin tjetër me zgjedhje në orën 11:30. Provimin e gjuhës së huaj Anglisht “TOEFL Junior Standard Test” e japin në orën 13:30.

11. Kandidatët që japin provim me zgjedhje vetëm gjuhën e huaj Anglisht “TOEFL Junior Standard Test”, hyjnë në provim në orën 13:30.

12. Maturantët/kandidatët mbetës në provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 i rijapin këto provime në sesionin e dytë.

Neni 5

### Dispozita të fundit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia

Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**

### URDHËR

Nr. 13, datë 1.4.2016

### PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, neneve 27–33, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, bazuar në faktin se sipas Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 3/2016, ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike i ngarkohen një sërë detyrash dhe përgjegjësish, bazuar në faktin se ministri i Shtetit nuk disponon një aparat ministror që të mbështesë veprimtarinë e tij, si dhe bazuar në parashikimet e marrëveshjes së lartpërmendur, e cila kërkon ngritjen dhe mbajtjen në funksionim të Njësisë së Menaxhimit të Projektit gjatë gjithë zbatimit të projektit për të kryer përgjegjësitë e menaxhimit të përgjithshëm të tij,

### URDHËROJ:

Delegimin e kompetencave që ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike gëzon në bazë të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 3/2016, tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), si më poshtë:

1. ADISA-ja realizon komunikimin zyrtar me institucionet dhe njësitë e tjera të përfshira në projekt, për të përmbushur realizimin e aspekteve teknike të veprimtarive të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes.

2. ADISA-ja lidh të gjitha kontratat që janë të



nevojshme për zbatimin e detyrimeve të marra përsipër në kuadër të Marrëveshjes dhe për realizimin e projektit, të përmendura në planin e miratuar të prokurimit me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe në përfundim të procedurave të përzgjedhjes të realizuara në përputhje me procedurat e kësaj Banke.

3. ADISA-ja realizon të gjitha funksionet e tjera me natyrë teknike të nevojshme për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja dhe për realizimin e projektit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHTETIT PËR  
INOACIONIN  
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE  
**Milena Harito**

#### VENDIM

Nr. 19, datë 1.4.2016

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtari	“	“
Sokol Berberi	anëtari	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtari	“	“
Gani Dizdari	anëtari	“	“
Besnik Imeraj	anëtari	“	“
Fatos Lulo	anëtari	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.11.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 56/14 Akti që i përket:

KËRKUES: Cukal Delija, përfaqësuar nga av. Përparim Sanxhaku

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-1091, datë 8.5.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 449 i Kodit të Procedurës Penale; nenet 31, 42/ç, 51/1, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”; rezoluta e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr. 75, datë 21.5.1975, “Për kriteret e rregullimit të seancave të mbajtura në mungesë të të akuzuarit”.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, Cukal Delijës, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

#### I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 13, datë 24.1.2005, ka vendosur, ndër të tjera, deklarinimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprave penale “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror” dhe “Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, të parashikuara nga nenet 297/2 dhe 298/3 të Kodit Penal (KP-ja), dhe dënimin e tij përfundimtar me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim e 1 000 000 (një milion) lekë gjobë.

2. Kundër vendimit të mësipërm ka bërë ankim mbrojtësi i kërkuarit, i cili ka qenë pajisur me prokurë nga të afërmit e tij. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 461, datë 27.12.2005 ka vendosur, ndër të tjera, lënien në fuqi të vendimit nr. 13, datë 24.1.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për sa i përket kërkuarit.

3. Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi, mbi rekursin e paraqitur nga mbrojtësi i kërkuarit, me vendimin nr. 536, datë 22.6.2007, ndër të tjera, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 461, datë 27.12.2005, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe pushimin e gjyqësorisë në ngarkim edhe të kërkuarit për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 i KP-së, për shkak se fakti nuk përbën veprë penale. Ndryshimin e këtij vendimi vetëm për sa u përket masave të dënimit me burgim dhe dënimin e kërkuarit me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim”.



4. Kërkuesi është ekstraduar nga Italia në vitin 2012 dhe i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në mungesë të tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-1091, datë 8.5.2014, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

## II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 13.3.2015, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-1091, datë 8.5.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me pretendimin se ky vendim i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimit e mëposhtme:

5.1. Gjykatat e zakonshme e kanë shqyrtuar çështjen në mungesë të kërkuesit pa marrë masa për njoftimin efektiv të tij. Për sa kohë ato nuk kanë deklaruar se i gjykuari i fshihej drejtësisë, kërkuesi duhet të përfitojë nga garancitë e nenit 33/1 të Kushtetutës, për më tepër kur interesat e tij ligjorë janë përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët, që ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit në të gjitha shkallët e gjyqimit të çështjes penale.

5.2. Edhe pse si bazë ligjore e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë është përcaktuar neni 449/1 të KPP-së, ku parashikohet se ajo mund të paraqitet në çdo kohë nëse e lejon ligji, Kolegji Penal e ka bazuar vendimin e mospranimit të kërkesës për rishikim në analizën ligjore të nenit 450 të KPP-së, që parashikon rastet e rishikimit të vendimit gjyqësor.

5.3. Kolegji Penal nuk ka respektuar nenet 42/ç dhe 51/1, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, dispozita të cilat e legjitimojnë kërkuesin të paraqesë kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë.

5.4. Mospranimi i kërkesës për rishikimin e vendimeve gjyqësore bie ndesh edhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, e cila në raste të ngjashme me atë të kërkuesit ka pranuar kërkesën për rishikim dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatat më të ulëta.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

6.1. Vendimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me Kushtetutën, Konventën për Ekstradimin, si dhe ligjin, pasi kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë është bërë për shkaqe jashtë përcaktimeve në mënyrë shteruese të nenit 450 të KPP-së.

6.2. Procesi gjyqësor penal në ngarkim të kërkuesit, i cili ka qenë në mungesë, është zhvilluar përpara se Gjykata Kushtetuese të merrte vendimin nr. 30, datë 17.6.2010, ku paraqitja e ankimit nga avokati i caktuar nga familjarët e të pandehurit deklarohet si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

6.3. Gjykimi në mungesë është bërë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në kohën kur janë marrë vendimet penale, prandaj kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë, në tejkallim të përcaktimeve të nenit 450 të KPP-së, cenon parimin *ne bis in idem* dhe sigurinë juridike.

6.4. Referimi në nenet 51/1 dhe 42/1/ç, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” është i gabuar dhe nuk justifikon kërkesën për rishikim të vendimit të formës së prerë. Garancitë për personin që ekstradohet sipas parimit të specialitetit, ku përfshihet edhe e drejta për rishikimin e vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij, duhet të parashikohen në fillim të procedurës për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim.

6.5. Procedura e ndjekur për ekstradimin e kërkuesit nuk është shoqëruar me kërkesë të ministrit të Drejtësisë të shtetit italian, ku t’i kërkohej ministrit të Drejtësisë të shtetit shqiptar garantimi i së drejtës së rishikimit të vendimit të formës së prerë. Për sa i takon së drejtës së ministrit të Drejtësisë, ajo nuk mund të jetë e pakufizuar dhe në tejkallim të përcaktimeve të nenit 450 të KPP-së.

6.6. Kërkuesi, si çdo shtetas tjetër shqiptar i ekstraduar, ka pasur të drejtën që brenda 30 ditëve nga data 3.7.2012, kur është ekstraduar nga Italia, të paraqiste kërkesë për rishikimin e vendimit penal, e drejtë e cila nuk është ushtruar brenda afatit ligjor.

6.7. Gjykata Kushtetuese duhet të orientojë organet ligjvënëse për të plotësuar boshllëkun ligjor, sepse mungojnë kushtet dhe kriteret, si dhe procedurat që duhen ndjekur nga ministri i



Drejtësisë përpara se të japë pëlqimin për rishikimin e vendimit të formës së prerë.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Kërkuar legjitimohet *ratione personae*, pasi pretendimet e tij përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi individual kundër vendimit të Kolegjit Penal të datës 8.5.2014 është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 13.3.2015, duke respektuar afatin 2-vjeçar të përcaktuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata, përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve të kërkuarit, thekson se pretendimet e parashtruara mbi procesin e gjykimit në themel të çështjes penale ajo i vlerëson në drejtëm të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që duhet të përmbushë Gjykata e Lartë në respekt të së drejtës së aksesit në procesin e rishikimit të vendimeve gjyqësore penale.

9. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005, nr. 14, datë 17.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një raport i tillë ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36,*

*datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Bazuar në këto vlerësime, më poshtë Gjykata do të analizojë pretendimet e ngritura nga kërkuar, të cilat *prima facie* janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

12. Kërkuar pretendon se vendimi i Kolegjit Penal për mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë bie ndesh me garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në drejtëm të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe, si i tillë, duhet shfuqizuar. Sipas kërkuarit, Kolegji Penal nuk ka respektuar normat e së drejtës ndërkombëtare për ekstradimin, duke i mohuar kërkuarit të drejtën për të pasur një proces të ri gjyqësor, i cili t’i garantojë mundësinë për t’u dëgjuar si rezultat i gjykimit në mungesë.

13. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e



gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi është dënuar në mungesë me 15 vjet burg për veprën penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve shtetërorë e kryer në bashkëpunim në përfundim të një procesi penal, i cili është zhvilluar në periudhën kohore 2005–2007. Interesat ligjorë të kërkuesit në këto procese janë përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët e tij.

15. Në datën 13.1.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal, kurse në datën 16.3.2012 i ka drejtuar kërkesë Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin nga Italia të kërkuesit, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritet shqiptare dhe rezultonte të ishte arrestuar në Itali në datën 8.3.2012. Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë në datën 18.3.2012 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë me kërkesë për ekstradimin e kërkuesit, kërkesë kjo e bazuar në nenin 12/2/a të Konventës Evropiane për Ekstradimin, në nenin 49, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritet e huaja në çështjet penale”, si dhe në nenin 504 të KPP-së.

16. Gjykata vëren se pas ekstradimit nga Italia kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve të deklarimit fajtor dhe të dënimit të tij në mungesë, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

17. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nga përmbajtja e dispozitave procedurale penale për rishikimin (nenet 450 dhe

453 të KPP-së), rezulton se kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Ky kolegji verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkuesit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe praninë e kriterëve ligjorë për shqyrtimin e saj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim.

18. Në çështjen konkrete, Kolegji Penal në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin me arsyetimin se ajo është bërë jashtë rasteve të parashikuara nga neni 450 i KPP-së për goditjen e një vendimi penal të formës së prerë. Në vendimin e mospranimit Kolegji argumenton se “... *kërkuesi ka ngritur pretendime në lidhje me procesin e gjykimit të zhvilluar kundër tij, pretendime të cilat kanë qenë pjesë e shqyrtimit të themelut të çështjes. Kërkesa vjen ndesh me parimin e “sigurisë ligjore”, i cili përcakton se “kur gjykata vendos përfundimisht për një çështje, vendimi nuk mund të vibet në pikëpyetje... Në lidhje me pretendimin se duke qenë i ekstraduar gëzon të drejtën e rishikimit të vendimit, nga ana e kërkuesit nuk u paraqit ndonjë provë se nga ministri i Drejtësisë është dhënë garanci për rishikimin e vendimit.”*

19. Gjykata çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, analiza e të cilave përbën kompetencë funksionale të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke i dhënë çështjes një përgjigje përfundimtare. Për rrjedhojë, kërkuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale, duke përdorur kërkesën për rishikim si mjetin procedural ankimes të përshtatshëm, ashtu edhe në aspektin substancial.

20. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për akses në Gjykatën e Lartë është i papabuar.



## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Vitore Tusha

## MENDIM PAKICE

1. Jam i mendimit se kërkesa e shtetasit Cukal Delija, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, duhej pranuar për arsytet e mëposhtme.

2. Nga rrethanat e çështjes, sikurse konstaton edhe shumica, rezulton se kërkuuesi është dënuar në mungesë me 15 vjet burg për veprën penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufijve shtetërorë e kryer në bashkëpunim. Interesat ligjorë të kërkuuesit në këto procese janë përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët e tij (*shih paragrafin 14 të vendimit të shumicës*).

3. Kërkuuesi, pasi është shpallur në kërkim ndërkombëtar, është arrestuar në Itali dhe ekstraduar në vitin 2012, në bazë të kërkesës që Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë i ka drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë në mbështetje të neneve 12/2/a, të Konventës Evropiane për Ekstradimin, 49 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, si dhe 504 të KPP-së. Në këto kushte ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në mungesë të tij (*shih paragrafin nr. 15 të vendimit të shumicës*).

4. Kolegji Penal në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin, pasi ajo është bërë jashtë rasteve të parashikuara

nga neni 450 i KPP-së, me arsyetimin se “... kërkuuesi ka ngritur pretendime në lidhje me procesin e gjyqimit të zhvilluar kundër tij, pretendime të cilat kanë qenë pjesë e shqyrtimit të themelit të çështjes. Kërkesa vjen ndesh me parimin e “sigurisë ligjore”, i cili përcakton se “kur gjykata vendos përfundimisht për një çështje, vendimi nuk mund të vihet në pikëpyetje... Në lidhje me pretendimin se duke qenë i ekstraduar gëzon të drejtën e rishikimit të vendimit, nga ana e kërkuuesit nuk u paraqit ndonjë provë se nga ministri i Drejtësisë është dhënë garanci për rishikimin e vendimit” (*shih paragrafin nr. 18 të vendimit të shumicës*).

5. Shumica ka vlerësuar se argumentet e parashtruara nga kërkuuesi kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, analiza e të cilave përbën kompetencë funksionale të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Sipas Gjykatës (shumicës) kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuuesi është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke i dhënë çështjes një përgjigje përfundimtare. Për rrjedhojë, kërkuuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale, duke përdorur kërkesën për rishikim si mjetin procedural ankimes të përshtatshëm, ashtu edhe në aspektin substancial (*shih paragrafin nr. 19 të vendimit të shumicës*).

6. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret një trajtim i tillë i ngushtë formalo-juridik i problemit më thelbësor në këtë çështje, duke u kufizuar thjesht në interpretimin literal të nenit 450 të KPP-së, lë jashtë vëmendjes elementin më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, respektimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

7. Sikurse konstaton edhe shumica, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjyqimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës



dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se neni 42 i kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 45, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Ky qëndrim i Gjykatës është në një linjë me qëndrimet tashmë të konsoliduara të GJEDNJ-së apo gjykatave të tjera simotra. GJEDNJ-ja që në vitin 1975, në çështjen *Golder kundër United Kingdom* (çështja 4451/70, vendimi datë 21.2.1975, § 35), është shprehur se “do të ishte pakonceptueshme, sipas mendimit të Gjykatës, që neni 6 § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojë sidomos atë që në fakt bën të mundur përfitimimin e garancive të tilla, që është aksesit në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia, nuk do të kenë asnjë vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore”. Pra, duke bërë një interpretim të të “drejtave efektive”, GJEDNJ-ja në vendimin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* përcaktoi se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së,

do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor<sup>1</sup>.

10. GJEDNJ-ja edhe në çështjen *McElhinney kundër Irlandës* (aplikimi nr. [31253/96](#), § 33), si dhe në çështjen *T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (aplikimi nr. [28945/95](#), § 96), ka ritheksuar se e drejta e aksesit “është një aspekt i pandarë i garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe të shmangies së pushtetit arbitrar, që qëndrojnë në themel të konventës. Kështu, neni 6 § 1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të pasur çfarëdolloj pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykatë”.

11. Ndërsa Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur se “gjykatat nuk mund të injorojnë detyrimin për të respektuar të drejtën e aksesit të individit në gjykatë, përkundrazi ato kanë detyrimin ta respektojnë atë në çdo moment dhe të marrin të gjitha masat që ajo të realizohet **pavarësisht situatës juridike**” (BVerfGE 29, 45).

12. Nga sa më lart, ndryshe nga shumica, jam i mendimit se në aspektin kushtetues, edhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t'u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Pra, edhe pse si çdo e drejtë tjetër edhe e drejta e aksesit në gjykatë mund t'u nënshtrohet kufizimeve, ato duhet të jenë deri në atë masë sa të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Çka do të thotë se në balancën ndërmjet së drejtës së aksesit dhe mënyrës së interpretimit të ligjit, e drejta e aksesit duhet të mbizotërojë.

13. Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm brenda hapësirës së juridiksionit të tyre, në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe të parimit të kushtetutshmërisë, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve janë të detyruara të bëjnë një interpretim pajtues të ligjit që duhet të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete me standardet kushtetuese. Gjykata ka theksuar tashmë se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë

<sup>1</sup> Shih The European Convention on Human Rights, Jacobs & White, Oxford, Fourth Edition, f. 170.



gjyqësor, lipset që kjo gjykatë, në përputhje edhe me nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, të mos kufizohet vetëm në dispozitat e këtij kodi, por të zbatohet drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse kjo nuk është e mundur, në rast se nga interpretimi i ligjit konkret ose për shkak të ometimit të tij cenohen standardet kushtetuese (e drejta e aksesit në çështjen në gjykim), gjyqtari/gjyqtarët duhet t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar antikushtetutshmërinë e ligjit.

14. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta interpretuar nenin 450 të KPP-së atë në harmoni me dispozitat e tjera procedurale penale, si dhe me frymën e Kushtetutës dhe nuk ka shfrytëzuar rrugën e kontrollit incidental për kushtetutshmërinë e normës juridike në fjalë (për shkak të ometimit në përmbajtjen e saj). Ajo nuk ka mbajtur në konsideratë as faktin se neni 39/2 i Kushtetutës parashikon se ekstradimi mund të lejohet kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike në Çështjet Penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre” (në vijim “marrëveshja e ekstradimit”). Sipas kësaj marrëveshjeje, e cila ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2011, të dyja shtetet, si palë kontraktuese, kanë njohur dhe pranuar reciprocisht juridiksionin penal të autoriteteve të drejtësisë të shteteve të tyre mbi shtetasit e vet, gjë që ka sjellë një cedim reciprok të sovranitetit të tyre në fushën e drejtësisë penale ndaj shtetasve të vet që ndodhen në territorin e shtetit të tyre.

15. Gjithashtu, Gjykata e Lartë, për të arritur në një përfundim sa më të drejtë lidhur me zgjidhjen e çështjes, nuk ka marrë parasysh as qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*), e cila ka theksuar se detyrimi për të garantuar paraprakisht respektimin e së drejtës

për rigjykim të të ekstraduarit vjen si pasojë e ratifikimit nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998 të Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë<sup>2</sup>, në nenin 2 të së cilës parashikohet se “kur një nga shtetet palë kërkon nga shteti tjetër palë ekstradimin e një personi për qëllim të ekzekutimit të një vendimi ose dënimi të vendosur nga një vendim i dhënë ndaj tij in absentia, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin, nëse, sipas saj, procedurat që çuan në marrjen e atij vendimi nuk kanë kënaqur të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për çdo person që akuzohet penalisht. Megjithatë, ekstradimi mund të lejohet nëse pala kërkuuese jep siguri të mjaftueshme se do të garantojë të drejtën e pretenduar të personit për një rigjykim, i cili do të sigurojë të drejtat e mbrojtjes. Vendimi për lejimin do të autorizojë palën kërkuuese ose të zbatojë vendimin në fjalë nëse personi i dënuar nuk e kundërshton këtë ose, nëse ai e kundërshton, të zhvillojë procedurat kundër personit të ekstraduar”.

16. Në të njëjtën kohë, neni 51 i ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” (ligj në të cilin është bazuar kërkesa për ekstradim në rastin konkret), lidhur me garancitë që gëzon personi i ekstraduar, përcakton se i ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, ka të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij, me përjashtim të rastit kur i ekstraduari ka hequr dorë nga këto të drejta dhe kur shteti i kërkuar e ka përcaktuar një gjë të tillë shprehimisht në kërkesë<sup>3</sup>.

17. Përkundrazi, Gjykata e Lartë ka zgjedhur “rrugën më të shkurtër”, atë të interpretimit të ngushtë të nenit 450 të KPP-së. Kësaj të mete

<sup>2</sup> RSH-ja ka miratuar ligjin nr. 10426, datë 2.6.2011, “Për ratifikimin e protokollit të tretë shtesë të Konventës Evropiane “Për ekstradimin””.

<sup>3</sup> Në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë gjendet e administruar shkresa nr. 2242/1 prot., datë 6.9.2013, e drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë pranë Ministrisë së Drejtësisë përmes së cilës i është kthyer përgjigje mbrojtësit të kërkuarit me këtë përmbajtje: “Ministria e Drejtësisë, pasi mori në shqyrtim kërkesën tuaj në lidhje me shtetasin Cukal Delia i ekstraduar nga Italia në Shqipëri, ju informon se nga verifikimi i akteve të disponuara nga kjo ministri nuk rezultoi të ketë deklaruar të këtij shtetasi për heqjen dorë nga e drejta e rishikimit të vendimit penal të dhënë në ngarkim të tij apo për mospranimin e një kërkesë të tillë”.





nuk ka mundur t'i shmanget as shumica në arsyetimin e vendimit të saj.

18. Për këto arsye jam i mendimit se kushtëzimi i së drejtës së rishikimit të vendimit penal të personit të ekstraduar, duke u mbështetur në një shqyrtim formal të ekzistencës apo jo vetëm të shkaqeve ligjore të parashikuara në nenin 450 të KPP-së, i cenon atij të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Në këtë këndvështrim çmtoj se Gjykata e Lartë duhet të synonte t'i jepte një zgjidhje kërkesës për rishikim të kërkuarit, duke zbatuar drejtpërdrejt Kushtetutën (interpretim pajtues të nenit 450 të KPP-së me Kushtetutën), apo t'i kërkonte kësaj Gjykate të vlerësonte kushtetutshmërinë e parashikimit ligjor konkret, nenit 450 të KPP-së, për shkak të ometimit të tij. Në rastin në shqyrtim, sikurse u theksua më lart, përderisa Gjykata e Lartë nuk e ka përmbushur këtë detyrim, ngelej detyrë e kësaj Gjykate të qartësonte kuptimin e dispozitës konkrete në pajtim me standardet kushtetuese.

19. Si përfundim, vlerësoj se në rastin konkret Gjykata e Lartë, duke mos pranuar kërkesën për rishikim të kërkuarit, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Anëtar: Vladimir Kristo

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete e çmujmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice, sepse nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Cukal Delija.

2. Nga rrethanat e çështjes konstatohet se pas ekstradimit nga Italia kërkuari ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve të deklarimit fajtor dhe të dënimit, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Baza ligjore e kërkesës referon në nenet 449 e në vijim të KPP-së, nenet 42/ç dhe 51/1 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", vendimin (75) 11, datë 21.5.1975 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Për kriterin e rregullimit të seancave të mbajtura në mungesë të të akuzuarit", në praktikën e Gjykatës së Lartë, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

3. Kolegji Penal në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e

vendimit me arsyetimin se "... kërkuari ka ngritur pretendime në lidhje me procesin e gjyqimit të zhvilluar kundër tij, të cilat kanë qenë pjesë e shqyrtimit të themelit të çështjes. Kërkesa vjen ndesh me parimin e "sigurisë ligjore", i cili përcakton se "kur gjykata vendos përfundimisht për një çështje, vendimi nuk mund të vibet në pikëpyetje." Në lidhje me pretendimin se duke qenë i ekstraduar gëzon të drejtën e rishikimit të vendimit, nga ana e kërkuarit nuk u paraqit ndonjë provë se nga ministri i Drejtësisë është dhënë garanci për rishikimin e vendimit."

4. Kërkuari ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se qëndrimi i mësipërm i ka cenuar atij të drejtën për akses në Gjykatën e Lartë, pasi Kolegji Penal nuk ka respektuar normat e së drejtës ndërkombëtare për ekstradimin, që i garantojnë kërkuarit të drejtën për të pasur një proces të ri gjyqësor ku mund të dëgjohet për pretendimet e tij, si rezultat i gjyqimit në mungesë.

5. Shumica e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Kolegjit Penal, duke argumentuar se "... argumentet e parashtruara nga kërkuari kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, analiza e të cilave përbën kompetencë funksionale të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji... kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuari është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke i dhënë çështjes një përgjigje përfundimtare. Për rrjedhojë, kërkuari e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale, duke përdorur kërkesën për rishikim si mjetin procedural ankimes të përshtatshëm, ashtu edhe në aspektin substancial" (shih § 19).

6. Jurisprudenca kushtetuese shqiptare, në dritën e asaj të GJEDNJ-së, ka ritheksuar në mënyrë të vazhdueshme domosdoshmërinë e forcimit dhe të respektimit të garancive që duhet të gëzojnë të gjykuarit në mungesë, veçanërisht në drejtim të ushtrimit efektiv të së drejtës së mbrojtjes, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe të aksesit në gjykim.

7. Garancitë në lidhje me procesin e ekstradimit janë ngritur në nivel kushtetues. Kushtetuta në nenin 39/2 parashikon se ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Për sa i takon kuadrin ligjor lidhur me ekstradimin, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë si shtesë e



Konventës Evropiane për Ekstradimin”, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike në Çështjet Penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre” (në vijim “marrëveshja e ekstradimit”). Sipas kësaj marrëveshjeje, e cila ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2011, të dyja shtetet, si palë kontraktuese, kanë njohur dhe pranuar reciprokisht juridiksionin penal të autoriteteve të drejtësisë të shteteve të tyre mbi shtetasit e vet, gjë që ka sjellë një cedim reciprok të sovranitetit të tyre në fushën e drejtësisë penale ndaj shtetasve të vet që ndodhen në territorin e shtetit të tyre.

8. Kuptimi i institutit të ekstradimit dhe veçanërisht i garancive që duhet të shoqërojnë këtë proces kanë gjetur trajtim edhe në jurisprudencën kushtetuese, e cila nga viti 2010 ka mbajtur qëndrimin se detyrimi për të garantuar paraprakisht respektimin e së drejtës për rigjykim të të ekstraduarit vjen si pasojë e ratifikimit nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, të Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë.

9. Në nenin 2 të Konventës për Ekstradimin parashikohet se *“kur një nga Shtetet Palë kërkon nga Shteti tjetër Palë ekstradimin e një personi për qëllim ekzekutimin e një vendimi ose dënimi të vendosur nga një vendim i dhënë ndaj tij në mungesë, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin, nëse, sipas saj, procedurat që kanë çuar në marrjen e atij vendimi nuk kanë kënaqur të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për çdo person që akuzohet penalisht. Megjithatë, ekstradimi mund të lejohet nëse pala kërkuuese jep siguri të mjaftueshme se do të garantojë të drejtën e pretenduar të personit për një rigjykim, i cili do të sigurojë të drejtat e mbrojtjes. Vendimi për lejimin do të autorizojë palën kërkuuese ose do të zbatohet vendimin në fjalë nëse personi i dënuar nuk e kundërshton këtë, ose, nëse ai e kundërshton, të zhvillojë procedurat kundër personit të ekstraduar”*.

10. Zhvillimet e reja të legjislacionit në fushën penale janë shoqëruar edhe me miratimin e ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i cili ka krijuar bazën e përshtatshme ligjore për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nëpërmjet detyrimeve që shteti shqiptar merr përsipër të realizojë për të përfutur një dimension më të plotë, për sa i përket mbrojtjes që siguron parimi i procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, Kuvendi ka miratuar edhe ligjin nr. 10426,

datë 2.6.2011, “Për ratifikimin e protokollit të tretë shtesë të Konventës Evropiane “Për ekstradimin””, që ka për qëllim plotësimin e konventës në disa aspekte për të lehtësuar dhe përsheptuar procedurën e ekstradimit kur personi i kërkuar jep pëlqimin për ekstradimin.

11. Garancitë në lidhje me personin e ekstraduar të gjykuar në mungesë përfshijnë, midis të tjerash, të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij, me përjashtim të rastit kur i ekstraduarit ka hequr dorë nga këto të drejta dhe kur shteti i kërkuar e ka përcaktuar një gjë të tillë shprehimisht në kërkesë (*nenet 42/1/ç dhe 51/1 të ligjit nr. 10193/2009*). Vendimi penal i formës së prerë, i dhënë ndaj personit të ekstraduar nga autoritetet gjyqësore vendase, në mungesë të tij, mund të rishikohet me kërkesë të të ekstraduarit, nëse ministri i Drejtësisë i ka dhënë një garanci të tillë shtetit të kërkuar. Kërkesa për rishikim paraqitet brenda 30 ditëve nga mbërritja e të ekstraduarit në territorin shqiptar dhe shqyrtimi i saj ndjek rregullat e Kodit të Procedurës Penale (*neni 51/4*).

12. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, jemi të mendimit se shumica, për të vlerësuar bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të kërkuarit për cenimin e aksesit, duhet të analizonte nëse roli që ka luajtur Gjykata e Lartë përputhet me atë të gjykatës së ligjit, ose e thënë ndryshe nëse Kolegji Penal, bazuar në rregullimet e parashikuara në nenin 122 të Kushtetutës, ka përmbushur detyrimin për të interpretuar konceptin kushtetues të vetëzbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Një vlerësim i tillë gjen mbështetje në rrethanat e çështjes konkrete nga të cilat rezulton se procesi i ekstradimit është vënë në lëvizje bazuar në kërkesën që Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë i ka drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë, në datën 18.3.2012. Kërkesa në pjesën hyrëse referon në Konventën Evropiane për Ekstradimin dhe dy protokollat shtesë të saj, ndërkohë që në bazën ligjore evidentohet neni 12/2/a i Konventës, neni 49, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, si dhe neni 504 i KPP-së.

13. Po ashtu vlerësojmë se shumica duke e analizuar qëndrimin e Kolegjit Penal vetëm në kontekstin e detyrimit për interpretimin e shkaqeve



të rishikimit e ka shkarkuar atë nga detyrimi për zbatimin e garancive të KEDNJ-së dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me rihapjen e një procesi të ri penal për të gjykuarin në mungesë, nëse nuk rezulton që ai t'i jetë fshehur drejtësisë, në referim të nenit 33 të Kushtetutës.

14. Gjithashtu, mendojmë se kërkesa duhet të ishte pranuar nga shumica dhe çështja duhet të kthehej për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë edhe për nevojat e qartësisimit dhe, në rast se çmohet e nevojshme, të unifikimit të praktikës gjyqësore lidhur me vlerën përcaktuese të garancisë së ministrit të Drejtësisë në rishikimin e vendimit penal, në kuptimin që në mungesë të një garancie të tillë a duhet që kërkuesi të përfitojë nga garancitë e përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare, kur këto të fundit e ofrojnë mundësinë e rishikimit të vendimit penal të formës së prerë.

15. Vlerësimi i mësipërm bazohet në faktin se në çështjet që i janë paraqitur për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese qëndrimet e mbajtura nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me çështjen e garancisë së ekstradimit në kohë të ndryshme rezultojnë të ndryshme. Në ato raste kur Ministria ka dhënë garanci për rishikimin e vendimit penal të të gjykuarit në mungesë dhe Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën për rishikim, vendimi i Kolegjit Penal është vlerësuar nga Ministri i Drejtësisë si “... si një situatë që ka krijuar në disa raste edhe precedentin negativ për shtetet e huaja lidhur me imazhin e mosrespektimit të garancive të dhëna për rigjykimin e këtyre shtetasve” (shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Ndërkohë, në rastin konkret, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përgjigjen drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 19.6.2015, arsyeton se “...Ministria e Drejtësisë në asnjë rast nuk ka dhënë garanci për këtë subjekt apo të jetë shprehur për pranimin ose mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit penal, në kushtet kur sipas legjislacionit shqiptar është gjykata që disponon me vendim për pranimin ose jo të kërkesës për rishikim vendim?”. Nga aktet bashkëngjitur kërkesës konstatohet se e njëjta përgjigje i është dhënë nga MD-ja edhe mbrojtësit të kërkuesit me shkresën e datës 17.5.2015.

16. Në shtetin e së drejtës vlen në çdo kohë prezumimi që autoritetet shtetërore duhet të

ushtrojnë funksionet e ngarkuara në përputhje me parimin e kushtetutshmërisë dhe atë të ligjshmërisë, duke pasur si objektiv të përhershëm garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në përgjithësi dhe veçanërisht të atyre shtetasve që janë dënuar në mungesë. Shumica, duke pranuar si të bazuar një qëndrim tërësisht formalist të Kolegjit Penal, ka lejuar që garancitë që burojnë për të ekstraduarit të gjykuar në mungesë nga legjislacioni vendas dhe ai ndërkombëtar të varen nga vullneti i ministrit të Drejtësisë, duke krijuar kështu premisat për dyshime serioze për cenimin e së drejtës së mbrojtjes së kërkuesit, aksesit të tij në gjykim, mosdhënien e drejtësisë efektive dhe mosrespektimin maksimal të së drejtave të njeriut.

17. Bazuar në sa më sipër mendojmë se qëndrimi i shumicës duhet të ishte i ndryshëm edhe për faktin se vetë subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, si organi i ngarkuar me kompetenca specifike në procesin e ekstradimit, ka kërkuar që “... Gjykata Kushtetuese duhet të orientojë organet ligjvënëse për të plotësuar boshllëkun ligjor, sepse mungojnë kushtet dhe kriteret, si dhe procedurat që duhen ndjekur nga ministri i Drejtësisë përpara se të japë pëlqimin për rishikimin e vendimit të formës së prerë”.

18. Në përfundim mendojmë se shumica në rastin konkret nuk kishte arsye për të ndryshuar jurisprudencën kushtetuese për më tepër kur në kushtet e një qëndrimi të ndryshëm ligjor nga Ministria e Drejtësisë lidhur me garancinë e rihapjes së procesit penal në rast ekstradimit të të gjykuarit në mungesë, interpretimi i konceptit kushtetues të vetëzbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të, është në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka në juridiksionin e vet zgjidhjen përfundimisht të çështjes konkrete.

19. Për rrjedhojë vlerësojmë se kërkesa e kërkuesit Cukal Delija duhej pranuar si e bazuar dhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të ishte shfuqizuar për t'i dhënë mundësi kërkuesit të gjykuar në mungesë të dëgjohej lidhur me pretendimet e tij.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vitore Tusha

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë